

**Golden Eagle Shpk.**  
**Raporti i audituesit të pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare më dhe për**  
**vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR</b>	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO</b>	<b>6</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE</b>	<b>7</b>
<b>SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>8-27</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar Ortakëve dhe Drejtuesve të Shoqërisë Golden Eagle Shpk.**

### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Golden Eagle Shpk. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 dhe pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare më dhe për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

### **Bazat për Opinionin**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave të veçanta financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

### **Çështje për t'u theksuar**

Ne tërheqim vëmendjen mbi shënimin 3.13 në pasqyrat financiare ku përshkruhet vlerësimi i drejtimit për aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (Vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.


*Deloitte Audit Albania Shpk*

Deloitte Audit Albania Shpk

Rr. Faik Konica, Ndërtesa nr.6 Hyrja nr. 7, 1010,

Tiranë, Shqipëri

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H



Enida Cara  
Auditues ligjor  
Partner Angazhimi

Tiranë, Shqipëri  
30 mars, 2021

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
<b>Aktivitet</b>			
<b>Aktivitet Afatshkurtra</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4	175,444	268,463
Inventari	5	10,332	12,178
Tatim fitimi i parapaguar	23	3,883	-
Të arkëtueshme tregtare	6	5,942	23,989
Shpenzime të parapaguara	8	1,935	3,163
Të arkëtueshme të tjera	9	-	5,496
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>197,536</b>	<b>313,289</b>
<b>Aktivitet Afatgjata</b>			
Aktive afatgjata material	8	1,116,004	1,181,597
Aktive afatgjata jo-materiale		1,632	2,178
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>1,117,636</b>	<b>1,183,775</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,315,172</b>	<b>1,497,064</b>
<b>Detyrime</b>			
<b>Detyrime Afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	10	15,369	82,759
Të pagueshme të tjera	11	11,731	31,786
Tatim fitimi i pagueshëm	23	-	10,185
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>27,100</b>	<b>124,730</b>
<b>Detyrime Afatgjata</b>			
Depozita-Garanci për qiratë	12	5,248	4,226
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>5,248</b>	<b>4,226</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>32,348</b>	<b>128,956</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i paguar	13	533,925	533,925
Rezerva ligjore	13	20,286	20,286
Rezerva të tjera	13	21,046	21,046
Fitimi i pashpërndarë	13	792,851	684,239
(Humbja)/Fitimi i vitit	13	(85,284)	108,612
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,282,824</b>	<b>1,368,108</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>1,315,172</b>	<b>1,497,064</b>

*Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**GOLDEN EAGLE SHPK****Pasqyra e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

	<b>Shënime</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhura nga shitjet	14	248,563	700,149
Të ardhura te tjera	15	5,010	6,171
<b>Të ardhura bruto</b>		<b>253,573</b>	<b>706,320</b>
<b>Shpenzime</b>			
Ndryshime në gjendje inventar	16	(30,510)	(89,927)
Shpenzime personeli	17	(108,633)	(154,775)
Shpenzime operative	18	(78,544)	(139,146)
Tarifa menaxhimi	19	(26,587)	(80,306)
Shpenzime të tjera	20	(11,021)	(18,778)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	8	(80,230)	(83,438)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(335,525)</b>	<b>(566,370)</b>
<b>(Humbja)/Fitimi nga aktiviteti operativ</b>		<b>(81,952)</b>	<b>139,950</b>
<b>Kostot financiare neto</b>			
Shpenzime financiare neto	21	(2,811)	(8,336)
Fitimi neto nga kursi i këmbimit	22	(520)	(529)
<b>Shpenzimet financiare neto</b>		<b>(3,332)</b>	<b>(8,865)</b>
<b>(Humbja)/Fitimi para tatimit</b>		<b>(85,284)</b>	<b>131,085</b>
Shpenzime për tatim fitimin	23	-	(22,473)
<b>(Humbja)/Fitimi neto i vitit</b>		<b>(85,284)</b>	<b>108,612</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i (humbjeve)/ të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(85,284)</b>	<b>108,612</b>

*Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**GOLDEN EAGLE SHPK****Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

	Kapitali i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Teprica më 1 janar 2019</b>	532,936	20,286	21,046	815,326	1,389,594
Korrigjimi i kapitalit të paguar në mënyrë që ai të mbahet me kosto historike (shënimi 13)	989	-	-	(989)	-
Fitimi i vitit	-	-	-	108,612	108,612
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	<b>108,612</b>	<b>108,612</b>
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	(130,098)	(130,098)
<b>Teprica më 31 dhjetor 2019</b>	<b>533,925</b>	<b>20,286</b>	<b>21,046</b>	<b>792,851</b>	<b>1,368,108</b>
Humbja e vitit	-	-	-	(85,284)	(85,284)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	-	-
<b>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(85,284)</b>	<b>(85,284)</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2020</b>	<b>533,925</b>	<b>20,286</b>	<b>21,046</b>	<b>707,567</b>	<b>1,282,824</b>

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Drejtimi më 29 mars 2021 dhe janë firmosur nga:



R. Wolf Schmitt  
Administrator

Rogner Hotel Tirana  
Golden Eagle sh.p.k. - Accounting  
Blvd. Dëshmoret e Kombit, AL - 1000 Tirana  
Tel : +355 4 2235035

Manjola Malo  
Shefë kontabiliteti



*Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*



**GOLDEN EAGLE SHPK****Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
(Humbja)/Fitimi pas tatimit	(85,284)	108,612
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	80,230	83,438
Zbritje nga llogaria e arkëtueshme	1,412	1,515
(Rritje)/Rënie në llogaritë e arkëtueshme	21,219	(12,782)
Rënie në inventar	1,846	3,760
(Rritje)/Rënie në shpenzime të parapaguara	1,228	(464)
(Rënie)/Rritje në llogaritë e pagueshme	(67,390)	16,472
(Rënie) në llogari të pagueshme të tjera	(18,120)	(13,237)
Tatim fitimi i paguar	(14,068)	10,185
<b>Mjete monetare neto (përdorur në)/nga aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(78,927)</b>	<b>197,499</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(14,092)	(39,766)
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e investimit</b>	<b>(14,092)</b>	<b>(39,766)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e financimit</b>		
Dividendë të paguar	-	(130,098)
<b>Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë e financimit</b>	<b>-</b>	<b>(130,098)</b>
(Rënie)/Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	(93,019)	27,635
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	268,463	240,829
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit</b>	<b>175,444</b>	<b>268,464</b>

*Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Golden Eagle Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 5 qershor 1993, bazuar në vendimin nr. 3709/1 dhe vepron sipas dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është z. Rudolf Schmid.

Veprimtaria kryesore e Shoqërisë lidhet me ndërtimin dhe ofrimin e shërbimeve ekskluzive hoteliere dhe komerciale, të cilat përfshijnë hapësirë për zyra, dyqane dhe aktivitete të lidhura me shërbimin për funksionimin e kompleksit hotelier dhe tregtar. Kapitali i regjistruar i paguar i shoqërisë është 5,650 dollarë (ekuivalent me 533,925 lekë), i ndarë në 2 kuota si më poshtë: Rogner International Hotels dhe Resorts ka 24.19% të vlerës së aksioneve dhe Rogner GmbH ka 75.81% përkatësisht 1,367 dollarë (ekuivalent me 129,181 lekë) dhe 4,283 dollarë (ekuivalent me 404,744 lekë).

Shoqëria mëmë e shoqërisë është Rogner Family, e cila ka kontrollin e shoqërisë mbi Rogner GmbH.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria kishte 106 punonjës (2019: 146 punonjës).

## **2. Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), duke u bazuar në koston historike. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi parimin e vijimësisë së biznesit, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë të operojë në periudhat në vijim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësime dhe supozime. Drejtimi përdor gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Elementet e pasqyrave financiare që kërkojnë një nivel më të lartë të gjykimit ose subjektivitetit dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë një ndikim më të lartë, shpjegohen në shënimin 3.12.

Shumat janë shprehur në monedhën vendase lekë, përveçse kur shprehet ndryshe.

### **2.1 Zbatimi i standardeve kombëtare të tjera dhe të rishikuara të kontabilitetit.**

#### **2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën raportuese aktuale**

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (BSKK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshimet në SKK 3 "Instrumentet Financiare"** – E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- **Ndryshimet në SKK 4 "Inventarët"** – E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)
- **Ndryshimet në SKK 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SKK 6 "Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)
- **Ndryshimet në SKK 7 "Kontabilizimi i qirave"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)

**2.1 Zbatimi i standardeve kombëtare të tjera dhe të rishikuara të kontabilitetit (vazhdim)**

**2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën raportuese aktuale (vazhdim)**

- **Ndryshimet në SKK 8 "Të ardhurat"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)
- **Ndryshimet në SKK 9 "Kombinimet e bizneseve dhe Konsolidimi"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SKK 10 "Grantet dhe forma të tjera të Ndihmës"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)
- **Ndryshimet në SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SKK 12 "Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)
- **Ndryshimet në SKK 13 "Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet Konçesionare"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020)
- **Ndryshimet në SKK 14 "Trajtimi kontabël i Investimeve në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta"** - E detyrueshme për zbatim (Kërkesat e Standardit)

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

**3.1 Prezantimi i pasqyrave financiare**

Pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike.

**3.2 Transaksionet në monedhë të huaj**

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në lekë, që është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj janë të matura me koston historike, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet që kanë rezultuar nga këto transaksione njihen në pasqyrën e performancës financiare.

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**  
*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**4. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Mjete monetare në Bankë</b>	<b>173,306</b>	<b>263,390</b>
LEK	71,014	122,110
EUR	81,672	120,828
USD	20,620	20,452
<b>Mjete monetare në arkë</b>	<b>2,138</b>	<b>5,073</b>
EUR	1,129	3,179
LEK	965	1,843
CHF	44	38
USD	-	13
<b>Totali</b>	<b>175,444</b>	<b>268,463</b>

**5. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhet si më poshtë

	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>
Materiale/proukte për klientët	4,047	3,176
Ushqim	1,705	3,214
Pije	1,977	2,779
Te linjta, uniforma, mjete kuzhine, kancelari, cigare etj.	1,824	2,346
Produkte pastrimi dhe sanitare	779	663
<b>Totali</b>	<b>10,332</b>	<b>12,178</b>

**6. Të arkëtueshme tregëtare**

Te arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhet si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>
Të arkëtueshme nga aktiviteti operativ	5,942	22,641
Të arkëtueshme të pa faturuara	-	1,348
<b>Totali</b>	<b>5,942</b>	<b>23,989</b>

**7. Shpenzimet e parapaguara**

Shpenzimet e parapaguara më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>
Shpenzime të parapaguara	1,935	3,163
<b>Totali</b>	<b>1,935</b>	<b>3,163</b>

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**  
*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**8. Aktive afatgjata materiale**

Aktivitet materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

Kosto	Ndërtesa	Mobilje dhe pajisje zyre	Mjete transporti	Ndërtime në progres	Totali
Teprica më 31 dhjetor 2019	2,511,322	545,908	3,158	15,325	3,075,713
Shtesa	5,565	23,521	-	(14,993)	14,093
Teprica më 31 dhjetor 2020	2,516,886	569,429	3,158	332	3,089,806
Zhvierësimi i akumuluar					
Teprica më 31 dhjetor 2019	(1,454,433)	(437,118)	(2,565)	-	(1,894,116)
Amortizimi për vitin	(52,996)	(26,571)	(119)	-	(79,685)
Teprica më 31 dhjetor 2020	(1,507,429)	(463,688)	(2,684)	-	(1,973,801)
Vlera e mbetur					
Më 31 dhjetor 2019	1,056,889	108,790	593	15,325	1,181,597
Më 31 dhjetor 2020	1,009,458	105,740	474	332	1,116,004

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk është vendosur si kolateral ndaj huamarrjes nga palë të tjera më 31 dhjetor 2020. (2019: asnjë).

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**9. Të arkëtueshme të tjera**

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Garancia bankare	-	1,328
Të arkëtueshme nga shteti	-	3,930
TVSH e arkëtueshme	-	238
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>5,496</b>

**10. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Të pagueshme nga aktiviteti operativ	7,782	23,542
Të pagueshme për palët e lidhura	7,587	59,217
<b>Totali</b>	<b>15,369</b>	<b>82,759</b>

**11. Të pagueshme të tjera**

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Shpenzime të përlllogaritura personeli	9,040	4,874
Të pagueshme të tjera	1,316	2,107
TVSH e pagueshme	1,065	-
Të ardhurat të shtyra	306	-
Shpenzime të përlllogaritura	5	24,805
<b>Totali</b>	<b>11,731</b>	<b>31,786</b>

**12. Garanci Qeraje**

Depozitat – garanci, për ambjentet e dhena me qira më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Garanci qeraje	5,248	4,226
<b>Totali</b>	<b>5,248</b>	<b>4,226</b>

Zëri garanci qiraje lidhet me garancinë të marra nga klientet, për ambjentët e të dhëna me qera.

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**13. Kapitali i paguar**

Tabela më poshtë tregon strukturën e kapitalit të Shoqërisë për 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Vlera e kuotave në USD	Vlera e kuotave në lekë	Kuotat në %
Rogner GmbH	4,283	404,744	75.81
Rogner International Hotels and Resorts	1,367	129,181	24.19
<b>Totali</b>	<b>5,650</b>	<b>533,925</b>	<b>100</b>

Më 31 dhjetor 2020, kapitali i paguar i regjistruar i Shoqërisë është 5,650 dollarë (ekuivalent me 533,925 lekë), i ndarë në 2 kuota si vijon: Rogner International Hotels dhe Resorts me 24.19% të vlerës së aksioneve dhe Rogner GmbH me 75.81% përkatësisht 1,367 dollarë (ekuivalente me 129,181 lekë) dhe 4,283 dollarë (ekuivalent me 404,744 lekë).

**14. Të ardhurat**

Të ardhurat nga shitjet më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga akomodimi	104,917	372,856
Të ardhura nga ushqimet	49,581	178,071
Të ardhura nga pijet	30,062	69,852
Të ardhura nga qeraja dhe të ardhura të tjera	42,241	39,848
Të ardhura operative të tjera	21,763	39,522
<b>Totali</b>	<b>248,563</b>	<b>700,149</b>

Gjatë vitit 2020 ka pasur një rënie të ndjeshme të të ardhurave nga aktivitetet kryesore të Shoqërisë. Ulja është rezultat i masave të zbatuara nga autoritetet lokale dhe ndërkombëtare për të kufizuar përhapjen dhe ndikimin e pandemisë COVID-19, të tilla si ndalimi dhe kufizimi i udhëtimit, karantina e personave të infektuar, si dhe vendosja e kufizimeve në aktivitetin e biznesit, deri në mbylljen e tyre.

Të ardhurat e tjera operative përfshijnë të ardhurat e krijuara nga aktivitete të tjera të tilla si pishinë, tenis dhe shërbime të tjera të tilla si evente.

**15. Të ardhura të tjera**

Të ardhurat e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura të tjera	5,010	6,171
<b>Totali</b>	<b>5,010</b>	<b>6,171</b>

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhurat e krijuara nga shërbimet e transportit, shërbimet estetike si dhe dëmtshpërblimeve.

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**16. Ndryshimet në gjëndjen e inventarit**

Ndryshimet në inventar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e ushqimeve	14,621	44,882
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e pijeve	5,538	14,889
Ndryshime në artikujt e pastrimit dhe sanitare	3,972	7,320
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e materialeve për klientët	2,382	10,046
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e duhanit	1,031	1,856
Ndryshime në gjëndjen / ineqnatrin e uniformave	117	1,079
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e të linjtave	4	1,218
Ndryshime të tjera inventari	2,845	8,637
<b>Total</b>	<b>30,510</b>	<b>89,927</b>

**17. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit përbëhen nga paga dhe kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Shpenzimet e pages	93,540	138,267
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore	15,092	16,508
<b>Totali</b>	<b>108,633</b>	<b>154,775</b>



**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**18. Shpenzimet operative**

Shpenzimet administrative më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Energji elektrike	20,420	33,681
Taksa për ndërtesën	10,559	10,554
Shpenzime pastrim dhe qira të linjtash	5,252	21,955
Shpenzimet e komisionit për agjentët e udhëtimit	5,193	21,198
Shpenzime sigurie	4,928	4,502
Shpenzime furnizim me ujë e kanalizime	3,719	4,232
Mirëmbajtje telefonie dhe kompjuterash	3,594	2,848
Shpenzime telekomunikacioni	3,167	4,622
Shpenzime këshillimi	2,614	3,653
Shpenzime sigurimi prone	2,546	2,648
Qera toke	2,160	2,164
Evente speciale	1,661	3,239
Shpenzime mirmbajtje; ndërtesa	1,482	2,250
Shpenzime mirmbajtje; elektrike	1,144	1,071
Shpenzime mirmbajtje; lysterje	1,093	1,403
Lule dhe dekoracione	994	2,065
Shpenzime për taksa	974	925
Shpenzime mirmbajtje; ashensore	590	1,143
Shpenzime për muzikë dhe argëtim	236	2,506
Shpenzime udhëtimi	212	1,205
Shpenzime mirmbajtje; mobilie	120	1,068
Shpenzime trajnimi	90	1,572
Shpenzime mirmbajtje; kondicionere & dhoam frigotiferike	34	1,119
Shpenime për shërbime	-	802
Shpenzime të tjera operative	5,762	6,621
<b>Totali</b>	<b>78,544</b>	<b>139,146</b>

Shpenzime të tjera marketingu dhe promocioni janë të lidhura me dhuratat që ju jepen klientëve, shërbime fotografie dhe promocioni gjatë eventeve etj.

**19. Tarifat e menaxhimit**

Shpenzimet e tarifave të menaxhimit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Tarifa profesionale	9,202	9,125
Tarifa menaxhimi	8,575	46,560
Tarifa marketingu	5,035	14,069
Tarife honorari	3,776	10,552
<b>Totali</b>	<b>26,587</b>	<b>80,306</b>

**GOLDEN EAGLE SHPK****Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)***20. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Fatura e TVSH për stafin dhe përfaqësimin	6,900	12,235
TVSH e pazbritshme	1,454	1,825
Shpenzime provizioni në llogaritë e arkëtueshme	1,412	1,515
Shpezime banketi	613	960
Shpenzime të të drejtave të autorit	438	438
Shpenzime të tjera	204	1,805
<b>Totali</b>	<b>11,021</b>	<b>18,778</b>

**21. Shpenzime financiare neto**

Shpenzimet financiare neto më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Shpenzime financiare neto	(2,811)	(8,336)
<b>Totali</b>	<b>(2,811)</b>	<b>(8,336)</b>

**22. Humbjet nga diferencat nga këmbimi, neto**

Humbjet nga diferencat nga këmbimi neto më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Humbjet nga diferencat nga këmbimi	(10,423)	(8,679)
Fitimi nga diferencat nga këmbimi	9,903	8,150
<b>Totali</b>	<b>(520)</b>	<b>(529)</b>

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**23. Shpenzimi i tatim fitimit**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi mbi fitimin fiskal për vitin financiar 2020. Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptarë, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	(85,284)	131,085
Shpenzimet e pazbritshme	10,128	18,733
<b>Fitimi fiskal për vitin</b>	<b>(75,156)</b>	<b>149,818</b>
<b>Tatim mbi fitimin në 15%</b>	<b>-</b>	<b>22,473</b>

Shkalla tatimore efektive për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Shkalla tatimore efektive</b>	<b>-</b>	<b>17%</b>

Shpenzimet e pazbritshme nga ligji fiskal kanë pasur një ulje në krahasim me vitin paraardhës, kryesisht nga ulja e shpezimeve të përlogaritura.

Kthimet tatimore paraqiten çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten të përkohshme derisa autoritetet tatimore të shqyrtojnë kthimet dhe të dhënat e tatimpaguesit dhe të lëshohet një vlerësim përfundimtar. Ligjet dhe rregulloret tatimore janë subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Balanca e tatimit mbi fitimin të parapaguar/ (e pagueshme)</b>	<b>(10,185)</b>	<b>159</b>
Pagesat gjatë periudhës	14,068	12,129
Shpenzimi i Tatimit mbi të Ardhurat për periudhën	-	(22,473)
<b>Balanca e tatimit mbi fitimin të parapaguar / (e pagueshme)</b>	<b>3,883</b>	<b>(10,185)</b>

**GOLDEN EAGLE SHPK****Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)***24. Palët e lidhura**

Në rrjedhën e kryerjes së veprimtarisë operacionale, Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme më palët e lidhura. Palët e lidhura përfshijnë entitete “Rogner International Holtels and Resorts”, “SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.”, “Rogner Holding GmbH” and “Rogner GmbH”.

Për periudhën e mbyllur 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019, kanë ndodhur transaksionet me palët e lidhura si më poshtë:

	As at December 31, 2020	As at December 31, 2019
<b><i>Pozicioni financiar</i></b>		
<b>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</b>		
Rogner International Holtels and Resorts	-	-
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	-	-
Rogner Holding GmbH	-	-
Rogner GmbH	5	-
<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>-</b>
<b>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</b>		
Rogner International Holtels and Resorts	(7,336)	(32,905)
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	-	(4,906)
Rogner Holding GmbH	(251)	(7,429)
Rogner GmbH	-	(13,977)
<b>Totali</b>	<b>(7,587)</b>	<b>(59,217)</b>
<b><i>Performanca financiare</i></b>		
<b>Të ardhura nga palët e lidhura</b>		
Rogner International Holtels and Resorts	-	-
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	-	-
Rogner Holding GmbH	-	-
Rogner GmbH	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Blerje nga palët e lidhura</b>		
Rogner International Holtels and Resorts	(15,413)	(62,554)
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	(7,380)	(14,819)
Rogner Holding GmbH	(9,710)	(15,879)
Rogner GmbH	(7,172)	(14,612)
<b>Totali</b>	<b>(39,676)</b>	<b>(107,864)</b>
<b>Kompensimi i menaxhimit</b>		
Paga	4,023	6,651
Taksa	474	474
<b>Totali</b>	<b>4,497</b>	<b>7,125</b>

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**25. Angazhime dhe garanci**

Gjatë rrjedhës normale të biznesit të tij, Shoqëria mund të jetë e përfshirë në pretendime ligjorë ose veprime të palëve të treta. Në bazë të mendimit të Drejtimit të shoqërisë, përfundimi final në lidhje me këto çështje nuk do të ketë një efekt mbi pozicionin financiar të shoqërisë, ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

Shoqëria është në proces ligjor me Terenzio D'Allenën për rikthimin e tokës. Rasti është në pritje të seancës dëgjimore të gjykatës së lartë. Deri në datën e këtij raporti të auditimit nuk ka informacione të mëtejshme lidhur me rastin e lartpërmendur. Drejtimi do të mbrojë fuqishëm çështjen dhe vlerëson se masa do të lindë në favor të Golden Eagle Shpk.

**26. Menaxhimi i rrezikut financiar**

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor në aktivitetet e shoqërisë. Rreziqet më të mëdha me të cilat Shoqëria përballet janë ato që lidhen me rrezikun e tregut (duke përfshirë çmimin, normën e interesit dhe rrezikun e monedhës), riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit.

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria mban aktivet dhe detyrimet të shprehura në euro dhe dollarë. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më pak ose më shumë se detyrimet në këtë monedhë.

Ekspozimi i Shoqërisë me kursin e këmbimit në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Vlera kontabël (neto)</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>CHF</b>	<b>LEK</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	175,444	82,801	20,620	44	71,979
Llogari të arkëtueshme	5,942	-	-	-	5,942
Shpenzime të parapaguara	1,935	944	-	-	991
Të tjera të arkëtueshme	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>183,321</b>	<b>83,745</b>	<b>20,620</b>	<b>44</b>	<b>78,912</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Vlera kontabël (neto)</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>CHF</b>	<b>LEK</b>
Llogari të pagueshme	(7,782)	(184)	-	-	(7,598)
Të pagueshme me palët e lidhura	(7,587)	(7,587)	-	-	-
Të pagueshme të tjera	(11,731)	-	-	-	(11,731)
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>(27,100)</b>	<b>(7,771)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(19,329)</b>
<b>Pozicioni neto i kursit të këmbimit</b>	<b>156,221</b>	<b>75,974</b>	<b>20,620</b>	<b>44</b>	<b>59,583</b>

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

**26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)*

Më 31 dhjetor 2019	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	CHF	LEK
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	268,463	124,007	20,465	38	123,953
Llogari të arkëtueshme	23,989	12,012	-	-	11,977
Shpenzime të parapaguara	3,163	829	-	-	2,334
Të tjera të arkëtueshme	5,496	-	-	-	5,496
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>301,111</b>	<b>136,848</b>	<b>20,465</b>	<b>38</b>	<b>143,760</b>

Më 31 dhjetor 2019	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	CHF	LEK
Llogari të pagueshme	(23,542)	(4,925)	-	-	(18,617)
Të pageushme ndaj ortakëve	(59,217)	(59,217)	-	-	-
Të pagueshme të tjera	(31,786)	-	-	-	(31,786)
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>(114,545)</b>	<b>(64,142)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(50,403)</b>
<b>Pozicioni neto i kursit të këmbimit</b>	<b>186,566</b>	<b>72,706</b>	<b>20,465</b>	<b>38</b>	<b>93,357</b>

Më poshtë janë kurset e këmbimit të aplikuar gjatë vitit:

EUR	Kursi i këmbimit mesatar		Kursi i këmbimit në datën raportuese	
	2020	2019	2020	2019
	123.76	123.01	123.7	121.77

*Analiza e ndjeshmërisë së valutës së huaj*

Analiza e ndjeshmërisë më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit dhe ndryshimi i përcaktuar që ndodh në fillim të vitit financiar dhe është mbajtur konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë është një përcaktim i efekteve të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto, duke supozuar se të gjitha variablat e tjerë mbahen konstant:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Euro appreciates by 10%	7,597	7,271
Euro depreciates by 10%	(7,597)	(7,271)

*(ii) Rreziku tatimor*

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshimet që ndodhin shpesh. Si rezultat, transaksionet mund të sfidohet nga organet tatimore dhe Shoqëria mund të vlerësojë taksa shtesë, gjobat dhe interesin, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudhat mbeten të hapura për të shqyrtuar nga organet tatimore dhe doganore në lidhje me detyrimet tatimore për pesë vjet. Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të asnjë rrethanë, të cilat mund të

**GOLDEN EAGLE SHPK**  
**Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

sjellin një detyrim të mundshëm material në këtë drejtim.

**26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

*(iii) Rreziku i likuiditetit*

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, struktura e maturimit të detyrimeve financiare të Shoqërisë bazuar në pagesat e paskontuara është paraqitur si më poshtë:

<b>Menaxhimi i rrezikut financiar</b>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
<b>31 Dhjetor 2020</b>						
Mjete monetare me bankën	175,444	-	-	-	-	175,444
Të arkëtueshmet tregtare	3,669	929	992	352	-	5,94
Të arkëtueshmet e tjera	1,935	-	-	-	-	1,935
Shpenzimet e parapaguara	-	-	-	-	-	-
<b>Totali asetëve</b>	<b>181,048</b>	<b>929</b>	<b>992</b>	<b>352</b>	<b>-</b>	<b>183,321</b>
Detyrime nda klientëve	(6,016)	(524)	-	(1,242)	-	(7,782)
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(3,837)	(6,560)	-	2,810	-	(7,587)
Detyrime të tjera	(11,731)	-	-	-	-	(11,731)
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>(21,584)</b>	<b>(7,084)</b>	<b>-</b>	<b>1,568</b>	<b>-</b>	<b>(27,100)</b>
<b>Hendeku marxhinal</b>	<b>159,464</b>	<b>(6,155)</b>	<b>992</b>	<b>1,920</b>	<b>-</b>	<b>156,221</b>
<b>Hendeku kumulativ</b>	<b>159,463</b>	<b>153,309</b>	<b>154,301</b>	<b>156,220</b>	<b>156,220</b>	<b>-</b>
<b>Menaxhimi i rrezikut financiar</b>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>	<i>(Lek)</i>
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
<b>31 Dhjetor 2019</b>						
Mjete monetare me bankën	258,887	9,576	-	-	-	268,463
Të arkëtueshmet tregtare	22,171	572	1,246	-	-	23,989
Të arkëtueshmet e tjera	4,168	-	-	-	1,328	5,496
Shpenzimet e parapaguara	-	3,163	-	-	-	3,163
<b>Totali asetëve</b>	<b>285,226</b>	<b>13,311</b>	<b>1,246</b>	<b>-</b>	<b>1,328</b>	<b>301,111</b>
Detyrime nda klientëve	19,848	382	-	3,312	-	23,542
Detyrime ndaj palëve të lidhura	59,217	-	-	-	-	59,217
Detyrime të tjera	31,786	-	-	-	-	31,786
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>110,851</b>	<b>382</b>	<b>-</b>	<b>3,312</b>	<b>-</b>	<b>114,545</b>
<b>Hendeku marxhinal</b>	<b>174,375</b>	<b>12,928</b>	<b>1,246</b>	<b>(3,312)</b>	<b>1,328</b>	<b>186,566</b>
<b>Hendeku kumulativ</b>	<b>174,375</b>	<b>187,304</b>	<b>188,550</b>	<b>185,238</b>	<b>186,566</b>	<b>-</b>

**26. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

*(iv) Rreziku kreditor*

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për Shoqërinë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar dështon të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë dhe aktivet e tjera.

*(v) Rreziku i normës së interesit*

Rreziku i normës së interesit përcaktohet si rreziku ndaj fitimeve dhe vlerës ekonomike që rrjedhin nga lëvizjet e pafavorshme të normave të interesit. Më 31 Dhjetor, 2020 dhe 2019, nuk ka instrumente financiare që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të interesit.

**27. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të mëvonshme të ndodhura pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar, të cilat do të kërkonin rregullime ose shpjegime në këto pasqyrave financiare.